

**TETE Albania Tunnel & Mining Sha**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>Faqe</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO</b>	<b>6</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË</b>	<b>7</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>8-29</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Aksionarëve dhe Drejtimit të Tete Albania Tunnel & Mining Sha,

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tete Albania Tunnel & Mining Sha ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### Pasiguri materiale në lidhje me Parimin e vijimësisë

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues 2.4 të pasqyrave financiare duke theksuar se Shoqëria ka raportuar një humbje të akumuluar prej 209,406,464 Lek më 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: 88,419,469 Lek). Këto kushte, së bashku me çështjet e tjera të përshkuara në shënimin shpjegues nr. 2.4, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

#### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbledhjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji Miniera  
Tiranë, Shqipëri

Numër unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L41709002H

Tiranë, Shqipëri  
15 gusht 2018



Enida Cara  
Auditues Ligjor  
Partner i angazhimit

**TETE Albania Tunnel & Mining Sha**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)	Më 1 janar 2016 (riparaqitur)
<b>Aktive afatgjata</b>				
Aktive afatgjata materiale	5	1,018,459,885	84,516,331	55,424,743
Aktive afatgjata jo materiale	6	143,047	158,700	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,018,602,932</b>	<b>84,675,031</b>	<b>55,424,743</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>				
Inventari	7	5,560,332	-	-
TVSH e arkëtueshme	8	116,635,952	5,223,766	3,140,535
Aktive të tjera	9	25,518,396	7,356,649	716,483
Paraja dhe ekuivalentët e saj	10	13,605,476	13,621,433	878,264
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>161,320,156</b>	<b>26,201,848</b>	<b>4,735,282</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,179,923,088</b>	<b>110,876,879</b>	<b>60,160,025</b>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>				
Kapitali aksionar	11	44,000,000	44,000,000	44,000,000
Humbja e vitit		(209,406,464)	(88,419,469)	(36,424,938)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>(165,406,464)</b>	<b>(44,419,469)</b>	<b>7,575,062</b>
Hua bankare	12	1,032,180,772	64,271,915	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>1,032,180,772</b>	<b>64,271,915</b>	<b>-</b>
Llogari të pagueshme	13	227,586,887	28,178,146	7,213,426
Detyrime ndaj aksionarëve	14	71,624,713	59,819,652	39,153,943
Detyrime ndaj punonjësve	15	9,491,945	1,393,754	4,152,699
Detyrime të tjera	16	3,861,074	1,632,881	2,064,895
Detyrime të shtyra tatimore	17	584,161	-	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>313,148,780</b>	<b>91,024,433</b>	<b>52,584,963</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,179,923,088</b>	<b>110,876,879</b>	<b>60,160,025</b>

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i TETE Albania Tunnel & Mining Sha më 31 Korrik 2018 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

\_\_\_\_\_  
 Eyup Batal  
 Administrator



Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne faqen 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**TETE Albania Tunnel & Mining Sha****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)
Të ardhura	-	-
<b>Total të ardhura</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Shpenzime personeli	18 (46,202,405)	(4,928,365)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	7 (41,654,591)	-
Shpenzime operative	19 (77,623,766)	(19,233,173)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	5,6 (10,383,406)	(1,163,905)
	<b>(175,864,168)</b>	<b>(25,325,443)</b>
<b>Fitim/(humbje) financiare</b>	<b>20</b>	
Shpenzime interesi	(542,374)	(170,789)
Shpenzime të tjera financiare	(1,517,265)	(768,535)
Fitimet (humbjet) nga këmbimi monedhave të huaja	57,520,974	(25,729,764)
	<b>55,461,334</b>	<b>(26,669,088)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>	<b>(120,402,834)</b>	<b>(51,994,531)</b>
Shpenzim i tatim fitimit	21 (584,161)	-
<b>Humbja neto për vitin</b>	<b>(120,986,995)</b>	<b>(51,994,531)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-
<b>Totali i të humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>(120,986,995)</b>	<b>(51,994,531)</b>

Pasqyra e e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**TETE Albania Tunnel & Mining Sha**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)*

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
<b>Teprica më 1 janar 2016</b>	<b>44,000,000</b>	-	<b>44,000,000</b>
Korrigjim i gabimeve të viteve të mëparshme (shënimi 3.14)	-	(36,424,938)	(36,424,938)
<b>Teprica më 1 janar 2016 (riparaqitur)</b>	<b>44,000,000</b>	<b>(36,424,938)</b>	<b>7,575,062</b>
Humbja neto e vitit (riparaqitur)	-	(51,994,531)	(51,994,531)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të humbjeve gjithpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>(51,994,531)</b>	<b>(51,994,531)</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)</b>	<b>44,000,000</b>	<b>(88,419,469)</b>	<b>(44,419,469)</b>
Humbja neto e vitit	-	(120,986,995)	(120,986,995)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të humbjeve gjithpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>(120,986,995)</b>	<b>(120,986,995)</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2017</b>	<b>44,000,000</b>	<b>(209,406,464)</b>	<b>(165,406,464)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**TETE Albania Tunnel & Mining Sha**  
**Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)
<b>Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional</b>		
Humbja para tatimit	(120,402,834)	(51,994,531)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,383,406	1,163,905
Shpenzime interesi	38,012,188	170,789
Efekti i ndryshimeve në kurset e këmbimit mbi tepricën e parasë dhe ekuivalenteve të saj	12,713,424	227,881
<b>Para neto përdorur në aktivitetin operacional para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet</b>	<b>(59,293,816)</b>	<b>(50,431,956)</b>
Rritje në inventar	(5,560,332)	-
Rritje në TVSH e arkëtueshme	(111,412,186)	(2,083,231)
Rritje në aktive të tjera	(18,161,747)	(6,640,166)
Rritje në llogari të pagueshme	199,408,741	20,964,720
Rritje/(rënie) në detyrime të tjera	10,326,384	(3,190,959)
Interesat e paguara	(27,409,042)	(170,789)
<b>Para neto përdorur në aktivitetin operacional</b>	<b>(12,101,998)</b>	<b>(41,552,381)</b>
<b>Fluksi i Parasë nga aktiviteti i investimit</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(944,311,307)	(30,414,193)
<b>Para neto e përdorur në aktivitetin e investimit</b>	<b>(944,311,307)</b>	<b>(30,414,193)</b>
<b>Fluksi i Parasë nga aktiviteti i financimit</b>		
Disbursime nga huaja e aksionarëve	22,111,011	20,665,709
Shlyerje e huasë së aksionarëve	(10,848,324)	-
Disbursime nga huatë bankare	957,848,085	64,271,915
<b>Para neto gjeneruar nga aktiviteti i financimit</b>	<b>969,110,772</b>	<b>84,937,624</b>
<b>Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>12,697,467</b>	<b>12,971,050</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>	<b>13,621,433</b>	<b>878,264</b>
Efekti i ndryshimeve në kurset e këmbimit mbi tepricën e parasë dhe ekuivalenteve të saj	(12,713,424)	(227,881)
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>13,605,476</b>	<b>13,621,433</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

TETE Albania Tunnel & Mining Sha (“Shoqëria”) e filloi aktivitetin e saj në 2007 si shoqëri shërbimi në fushën minerare. Shoqëria është regjistruar si një person juridik sipas vendimit të Gjykatës datë 11 prill 2007, me numër NIPT-I K71627041B dhe zyra qendrore e saj është e vendosur në rrugën “Sami Frashëri”, kompleksi Nobis, kati i parë, Nr. 7/630-N29, Tiranë, Shqipëri. Vendimi i Asamblesë së aksionarëve më 5 qershor 2017 aprovoi ndryshimin e statusit ligjor të Shoqërisë nga shoqëri me pronësi të kufizuar në shoqëri aksionare.

Dy aksionarët e Shoqërisë janë TETE Madencilik ve Muhendislik Sanayi ve Ticaret A.S, e cila zotëron 49% të aksioneve dhe Ilbak Madencilik Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, e cila zotëron 51% të aksioneve. Palët përfundimtare kontrolluese të Shoqërisë janë: Murat Ilbak, Mustafa Ilbak, Ahmet Hamdi Gül, Mehmet Macit Gül dhe İbrahim Cem Yalçın.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është nxjerrja, përpunimi, pasurimi dhe shitja me shumicë dhe pakicë, import-eksporti i cfarëdo lloj minerali (si bakri, kromi, hekuri, nikeli, zinku, qymyrguri, etj). Shoqëria është gjithastu e përfshirë në përpunimin, prerjen, shitjen me shumicë dhe pakicë, import-eksportin e cfarëdolloj guri (si mermeri, granit, etj) deri tek përgatitja dhe shpërndarja e produkteve të përfunduara.

Shoqëria ka përfutuar një leje shfrytëzimi në 20 gusht 2007 nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë me jetëgjatësi 20 vjet për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit nga miniera ekzistuese e ndodhur në Spaç, Mirditë. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka qenë në process përfundimi të ndërtimit të fabrikës dhe tuneleve të minierës, dhe ka filluar nxjerrjen dhe përpunimin e bakrit në muajin qershor 2018. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 97 punonjës (2016: 13 punonjës).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare bashkangjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

### **2.2 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

### **2.4 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivitetet dhe shlyejë detyrimet gjatë rrjedhës normale të biznesit. Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka pësuar humbje neto për vitin në vlerën Lek 120,986,995 (2016: 51,994,531 Lek) dhe humbje të akumuluar në vlerën 209,406,464 Lek (2016: 88,419,469 Lek). Shoqëria është angazhuar në një projekt afatgjatë, i cili kërkon burime të konsiderueshme financiare. Aksionarët e Shoqërisë kanë deklaruar angazhimin e tyre të pakthyeshëm nëpërmjet një letre mbështetjeje të nënshkruar më 10 gusht 2018, për të vazhduar mbështetjen e Shoqërisë me kapital të mjaftueshëm punues dhe financim për 12 muajt e ardhshëm. Gjthashtu, nevojat financiare të Shoqërisë do të mbështeten me kredi nga banka e nivelit të dytë (Shënimi shpjegues 12) dhe nga marrëveshja e financimit me Traxys e nënshkruar më 20 shkurt 2018 (për detaje të metejshme ju lutem referojuni Shënimit shpjegues 24). Shoqëria ka përfutuar një leje shfrytëzimi në 20 gusht 2007 me jetëgjatësi 20 vjet për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit nga miniera ekzistuese e ndodhur në Spaç, Mirditë. Me ndryshimet në strukturën aksionare gjatë vitit 2016, Shoqëria është përfshirë aktivisht në fazën e zhvillimit në lidhje me ndërtimin e fabrikës dhe minierës e cila ka filluar në mes të dhjetorit 2016, ndërsa aktiviteti i veprimtarisë dhe nxjerrjes së mineraleve ka filluar në muajin qershor 2018. Shoqëria nuk ka qëllim të likuidojë ose të ndërpresë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2018. Drejtimi pret që Shoqëria të jetë fitimprurëse në të ardhmen dhe e aftë për të vijuar sipas parimit të vijimësisë, e cila e ben Drejtimin e Shoqërisë të mos identifikojë humbje të tjera nga zhvleresimi i mëtejshëm i aktiveve.

## **2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet kryesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni mbi elementë të rëndësishëm të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël që kanë një efekt shumë të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare, përshkruhet në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare, duke patur parasysh që Shoqëria është në fazë investimi dhe nuk ka nisur ende aktivitetin e prodhimit dhe të shitjes.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

### **3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën raportuese aktuale**

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 “Pasqyra e Lëvizjes së Parasë”** - Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 “Tatimi mbi të Ardhurat”** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk kanë rezultuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë.

### **3.2 Standardet dhe interpretimet që nuk janë ende efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme janë publikuar por nuk janë akoma në fuqi.

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 Janar 2018),
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione”,** - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentat Financiarë”** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.2 Standardet dhe interpretimet që nuk janë ende efektive (vazhdim)**

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Shoqëria ka vendosur të mos t'i aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre efektive. Shoqëria beson se aplikimi i standardeve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të aplikimit.

#### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

##### **(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël 3.6 (ii)).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar. Në kostot e minierës përfshihen kostot e materialeve direkte, kostot direkte të punës, kostot e huasë të lidhura drejtpërdrejt me investimin dhe punimet në minierë si kërkimet për burime minerare dhe vlerësimi i tyre, përmirësimet e galerive etj.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (elementët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhurat/shpenzimet e tjera operative në fitim ose humbje.

##### **(ii) Kostot vijuese**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)****3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)****(iii) Zhvlerësimi**

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas jetës së dobishme të aktiveve të llogaritur sipas metodës lineare. Në përcaktimin e jetës së dobishme të aktiveve, Shoqëria konsideron kufizimet ndaj përdorimit të aktiveve bazuar në kohëzgjatjen e licencës minerare prej 20 vjetësh. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet dhe përshtatet nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportuese. Përqindjet e amortizimit të aplikuara në kategoritë e ndryshme të aktiveve afatgjata materiale per vitin 2017 dhe 2016 janë si vijon:

<b>Kategoria e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale</b>	<b>Sipas Politikave Kontabël të Shoqërisë</b>
Përmirësime të Tokës	10%
Ndërtesa	10%
Pajistje informatike	10%
Makineri dhe paisje të tjera	10%
Mobilje dhe pajisje zyre	10%
Automjete	10%
Aktive të tjera afatgjata	10%
Kosto miniere	0%
Aktive në proces	0%

Aktivitet në proces dhe kosto e minierës nuk janë zhvlerësuar deri në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare derisa këto aktive të jenë të disponueshme për përdorim.

Pjesa më e madhe e aktiveve afatgjata materiale janë blerë gjatë 2017 dhe, duke u bazuar në kohëzgjatjen e licencës minerare, Shoqëria ka përcaktuar jetën e dobishme të aktiveve në 10 vite.

**3.4 Inventarët**

Inventarët janë vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin e kostos mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, kostot e shndërrimit dhe gjithë kostot e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus kostot e vlerësuara të përfundimit e shitjes.

**3.5 Instrumentat financiarë**

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë të përberë nga mjete monetare dhe ekuivalente me to, klientë dhe të tjera llogari të arkëtueshme, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme dhe huamarrje.

Shoqëria fillimisht njihet të arkëtueshmet dhe depozitat në datën e krijimit. Aktivitet financiarë çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivitet dhe detyrimet financiare prezantohen neto në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm në rast se Shoqëria ka të drejtën ligjore dhe qëllimin për të shlyer ose arkëtuar njëherësh detyrimin ose të drejtën neto.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.5 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

*Llogari të arkëtueshme e të tjera të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme klasifikohen në kategorinë e matjes “Hua dhe të arkëtueshme”. Të arkëtueshmet janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet kumulative nga zhvlerësimi (shih shënimin 3.6 (i)).

*Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë, depozitat rrjedhëse në banka dhe investime të tjera likuide afatshkurtra me maturim tre muaj ose më pak, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

*Detyrime financiare*

Detyrime të tjera financiare përfshijnë huamarrjet, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e pagueshme në datën kur ato janë krijuar. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus koston direkte të transaksionit. Në vazhdim, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në politikën kontabël 3.11.

*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

#### **3.6 Zhvlerësimi**

##### **(i) Aktive financiare**

Një aktiv financiar, i cili nuk regjistrohet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive e zhvlerësimit tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare të zhvlerësohen mund të përfshijë mospagimin nga huamarrësi, ristrukturimin e e shumë që i detyrohet Shoqërisë me kusht që Shoqëria nuk do t'i kishte konsideruar në një rast tjetër, të dhëna që një huamarrës do të falimentojë, ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësit ndaj Shoqërisë, kushte ekonomike që lidhen me dështimin e pagesave ndaj Shoqërisë ose zhdukja e një tregu aktiv për letrat me vlerë.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivit financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Aktivete financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme rreziku. Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor trendet historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.6 Zhvlerësimi (vazhdim)**

##### **(i) Aktive financiare (vazhdim)**

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në fitim ose humbje.

##### **(ii) Aktive jo-financiare**

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit ose e njësisë gjeneruese të parasë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

##### **(ii) Aktive jo-financiare (vazhdim)**

Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron flukse monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivitetet e tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë është me e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e pritshme të parasë skontoohen deri në vlerën aktuale të tyre duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton kushtet e vlerësuar të tregut dhe vlerën në kohë të parasë si dhe risqet specifike që lidhen me këtë aktiv.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

#### **3.7 Njohja e të ardhurave**

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka filluar ende aktivitetin e prodhimit dhe të shitjes dhe nuk ka gjeneruar të ardhura gjatë vitit 2017 (2016: asnjë).

#### **3.8 Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes të cilat i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aktivi të kualifikuar janë ato kosto të huamarrjes që do të ishin shmangur nëse shpenzimet për aktivin e kualifikuar nuk do të ishin bërë. Kur një njësi ekonomike huazon fonde në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të caktuar të kualifikuar, kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me atë aktiv të kualifikuar mund të identifikohen lehtësisht.

Në masën që një njësi ekonomike huazon fonde në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar, njësi ekonomike duhet të përcaktojë shumën e kostove të huamarrjes të pranueshme për kapitalizim, si shpenzimet aktuale të huamarrjes të bëra për atë huamarrje gjatë periudhës, minus çdo të ardhur nga investimi në investimin e përkohshëm e atyre huave.

Në masën që një njësi ekonomike huazon fondet në përgjithësi dhe i përdor ato për qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar, njësi ekonomike duhet të përcaktojë shumën e kostove të huamarrjes të pranueshme për kapitalizim duke aplikuar një normë të kapitalizimit në shpenzimet për atë aktiv. Shkalla e kapitalizimit është mesatarja e ponderuar e kostove të huamarrjes të zbatueshme për huamarrjet e njësisë ekonomike që janë të papaguara gjatë periudhës, përveç huave të marra në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar. Shuma e kostove të huamarrjes që një njësi ekonomike kapitalizon gjatë një periudhe nuk duhet të tejkalojë shumën e kostove të huamarrjes që ka ndodhur gjatë asaj periudhe.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.9 Provigjonet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parash dhe, sipas rastit, risqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

#### **3.10 Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

#### **3.11 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka, të ardhura nga efekti i kursit të këmbimit nga detyrimet ndaj aksionarëve dhe nga huaja bankare. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Kostot e huasë që nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt në rezultat duke përdorur metodën e interesit efektiv.

